



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 Qershor 2021
Nr. ref.:RK 1798/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI181/20

Parashtrues

Ndërmarrja private „Betoni“

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
E. Rev. nr. 225/20 të 27 korrikut 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga ndërmarrja private „Betoni“, (në tekstin e mëtejshëm: „P.P Betoni“), me seli në Xërxë, komuna e Rahovecit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Ymer Koro nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [E. Rev. nr. 225/2020] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 27 korrikut 2020, i cili iu dorëzua atij më 22 shtator 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 21, 22, 23, 24, 27, 28, 31, 46, 49, 53, 54, 55 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ) si dhe nenet 182, 183 dhe 184 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe nenet 375, 585 dhe 595 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (në tekstin e mëtejme: LMD).
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme, përmes së cilës do të pezullohej përmbarimi i aktgjykimit të formës së prerë C. nr. 199/2011 të Gjykatës Themelore në Rahovec të 21 qershorit 2012.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve], 39 [Kriteret e pranueshmërisë] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 30 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 31 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
9. Më 6 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
10. Më 13 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

11. Më 14 janar 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
12. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 1 maj 1994, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë mbi qiranë me M.G. për pronën e paluajtshme, përkatësisht dy parcelave kadastrale për një periudhë prej 10 vjetësh me qëllim të kryerjes së aktiviteteve të parashtruesit të kërkesës.
14. Në një datë të pacaktuar në vitin 2011, trashëgimtarët e M.G. parashtruan kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Rahovec kundër parashtruesit të kërkesës duke kërkuar ndërprerjen e kontratës së qirasë mbi pronën e paluajtshme si dhe pagimin e borxhit të mbetur të qirasë.
15. Më 21 qershor 2012, Gjykata Themelore në Rahovec, përmes Aktgjykimit C. nr. 199/2011, aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e trashëgimtarëve të M.G. ashtu që ndërpreu kontratën e qirasë së pronës së paluajtshme të 1 majit 1994 dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës për t'ia kthyer posedimin e parcelave të kontestuara trashëgimtarëve të M.G., duke demontuar objektet që ishin ngritur në këto ngastra, si dhe për t'ua paguar qiranë e mbetur trashëgimtarëve të M.G.
16. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore deklaroi:

„Nuk është kontestues fakti se kontrata mbi shfrytëzimin e patundshmërisë është lidhur në mese të ndërgjyqësve në afat 10 vjeçar dhe në këtë afat obligimet janë kryer nga të dy palët. Sipas të cilës kontratë janë të parapara kushtet e kontratës e të cilat faktet janë vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve '.

Sipas dispozitës të nenit 585 të Ligjit mbi marrëdhëniet Obligative, në paragrafin 4 të nenit parashihet: nëse gjatë periudhës së qirasë, qiramarrësi ka bërë ndonjë ndryshim në sendin e marrë me qira atëherë është i detyruar që sendin ta kthejë në gjendjen, në të cilën sendi ka qenë kur ka pranuar me qira, Ndërsa, në paragrafin 5 të njëjtit nen parashihet se qiramarrësi mund të i marrë shtesat (sendet) nëse ato mund të ndahen pa dëmtimin e sendit të dhënë me qira, ndërsa qiramarrësi mund të mbajë sendet në qoftë se e kompenson vlerën e tyre në kohën e kthimit, E drejta e qiradhënësit ka përparësi në raportin me të drejtën e qiramarrësit, që sendet e shtuara të i marrë.

Me angazhimin e ekspertëve përkatës të ndërtimtarisë dhe të bujqësisë, është bërë vlerësimi i objekteve të ndërtuara në patundshmërinë e paditësve si dhe është bërë vlerësimi i patundshmërisë nga ekspertët përkatës. Mirëpo, me vlerësimin e vlerës të objekteve nga ana e ekspertit përkatës dhe të patundshmërisë nga ana e ekspertëve përkatës, paditësit-kundër- paditurit nuk janë pajtuar që të i blejnë objektet të ndërtuara në parcelën e tyre sipas vlerësimit nga ana e ekspertit të ndërtimtarisë, e as e paditura kundër- paditësja nuk është pajtuar që paditësve kundër- paditurve të ua paguaj për patundshmërinë vlerën të caktuar nga ana e ekspertëve përkatës.

Si fakte relevante, për vendosjen e kësaj çështjes juridike, gjykata merr për bazë thëniet e ndërgjyqësve gjatë procedurës, kontratën të nënshkruar nga ana e ndërgjyqësve, deklaratat e dëshmitarëve të cekura më lartë, si dhe ekspertizat dhe mendimet e ekspertëve përkatës, për këtë arsye edhe e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve kundër paditurve, meqenëse ndërgjyqësit nuk kanë arritur marrëveshje lidhur me blerjen e objekteve e as të patundshmërisë“.

17. Më 29 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit (C. nr. 199/2011) të Gjykatës Themelore në Rahovec të 21 qershorit 2012 për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më 15 qershor 2015, Gjkata e Apelit, me Aktgjykimin Ae. nr. 4255/2012, refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin (C. nr. 199/2011) e Gjykatës Themelore në Rahovec.
19. Më 28 korrik 2015, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme përmes Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti në Rahovec kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale .
20. Më 20 gusht 2015, Gjkata Themelore në Gjakovë - Departamenti në Rahovec, përmes Aktvendimit C. nr. 199/2011, hodhi poshtë revizionin e parashtruesit të kërkesës si të palejueshëm sepse vlera e caktuar e kontestit në këtë rast nuk kalon 3000 €.
21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit (C. nr. 199/2011) të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti në Rahovec të 20 gushtit 2015 për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 5 dhjetor 2019, Gjkata e Apelit, me Aktvendimin Ae. nr. 4255/2012, aprovoi, si të bazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktgjykimin (C. nr. 199/2011) e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti në Rahovec të 20 gushtit 2015 dhe e përcolli lëndën në Gjykatën Supreme për vendimmarrje lidhur me revizionin e parashtruar të parashtruesit të kërkesës.
23. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, Gjkata e Apelit deklaroi:

„është e vërtetë që paditësi-kundër i padituri në padi kanë cekur se vlera e kontestit është 100 Euro, dhe se sipas vlerës e kanë paguar taksën gjyqësore. Është e vërtetë se i padituri-kundër paditësi në kundërpadi fare nuk ka cekur vlerën e kontestit. Megjithatë, me nenin 33 të LPK-së është paraparë kur kontesti ka të bëjë me ekzistimin e marrëdhënieve të cilat kanë të bëjnë me qira, vlera e kontestit llogaritet sipas vlerës së qirasë njëvjeçare, përveç nëse qiraja është lidhur për periudhë kohore më të shkurtër. Në rastin konkret është fjala për qira prej 250 Euro në muaj,

përkatësisht 3000 Euro vjetore, është e qartë se revizioni i paraqitur i plotëson kushtet me nenin 211 par. 2 të LPK-së. Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit gjen se ankesa e paraqitësit e revizionit duhet të aprovohet“.

24. Më 27 korrik 2020, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin E. Rev. nr. 225/2020, përmes të cilit refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të palejueshëm.
25. Në arsyetimin e aktvendimit lidhur me revizion, Gjykata Supreme deklaroi:

“Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ngriti padi për dorëzimin e pronës së patundshme dhe pjesës së mbetur të qirasë, dhe në padi si dhe në aktgjykimin e shkallës së parë, po ashtu edhe në shkallën e dytë, shuma e kontestit është 100.00 euro (njëqind euro. Padia u dorëzua në gjykatë më 28 shtator, 2006 dhe në emër të tarifës gjyqësore për padi, paditësi pagoi 7.5 euro (shtatë euro dhe pesëdhjetë cent).). [...] Me dispozitën e nenit 211.2 të LPK-së, revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilët kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në të hollat, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e kontestit nuk e tejkalon shumën prej 3.000,00 Euro (tre mijë euro).

26. Më 13 gusht 2020, me propozimin e trashëgimtarëve të M.G., përmbaruesi privat lëshoi Urdhrin P. nr. 07/18 për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë C. nr. 199/2011 të Gjykatës Themelore në Rahovec të 21 qershorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 21, 22, 23, 24, 27, 28, 31, 46, 49, 53, 54, 55 dhe 119 të Kushtetutës, të garantuara me nenin 6 të KEDNJ-së, të garantuara me nenin 10 të DUDNJ-së, si dhe nenet 182, 183 dhe 184 të LPK-së dhe nenet 375, 585 dhe 595 të LMD-së.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon që aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i përfshirë me shkelje esenciale të nenit 24 të Kushtetutës sepse *“kemi kërkuar: Super ekspertizë, nga ekspertë të cilët nuk janë nga Rahoveci, apo nga zona përreth, por ndonjë ekspert gjyqësor jashtë Rahovecit, i cili do të ishte i paanshëm dhe i cili do të kryente profesionalisht super ekspertizën e ngastrës së kontestuar. Gjyqtari pranoi kërkesën tonë, por caktoi një ekspert nga Rahoveci, i cili ishte i njëanshëm. Nuk e pranuan këtë ekspertizë. Kemi kërkuar ekspertë në fushën e bujqësisë, nga Fakulteti i Bujqësisë në Prishtinë, gjyqtari nuk e plotësoi kërkesën tonë“.*
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon që neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së janë shkelur sepse aktgjykimi i kontestuar *„nuk qëndron pretendimi i dhënë në arsyetimin të gjykatës së Revizionit se vlera e kontestit është 100, euro dhe revizioni të hudhet si i pa lejuar në kuptim të nenit 212,2 të LPC-së, kur palët paditëse kanë precizuar me parashtrës të dt. 15.02.2011, vlerën e kontestit 15.000 euro, dhe këtë shumë e ka gjykuar edhe Gjykata e shkallës së parë, dhe e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit e Kosovës. Në të vërtetë edhe po të kishin përcaktuar paditësit vlerën e kontestit 100 euro, pala ankuese nuk*

është fajtor për këtë përcaktim vlere, në mënyrë që revizioni të hidhet si i pa lejuar edhe për faktin se pala parashtruese-ankuese ka përcaktuar vlerën e kundërpadisë më të lartë se 3000 euro“.

30. Sa i përket neneve 21, 22, 23, 27, 46, 49, 53, 55 dhe 119 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës deklaron se „Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur Kushtetutën e Kosovës duke i mundësuar paditësit që përmes: *PËRMBARUESIT PRIVAT: GJOK RADI – GJAKOVË të fillojë REALIZIMIN E URDHRIT P. nr.=07/18 të 13.08.2020. Duke shkelur Kushtetutën e Kosovës sipas këtyre ligjeve si në vazhdim: Neni 21 [Parimet e Përgjithshme] pika 1, 2 dhe 3, neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit] pika 1, 2 dhe 3, neni 27 Citojmë: Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, neni 119 [Parimet e Përgjithshme] pika 1, 2 dhe 4, Ashtu që i ka mundësuar PËRMBARUESIT PRIVAT ta REALIZOJË URDHRIN PËR PËRMBARIM, duke shkelur ligjet Kushtetutën e Kosovës dhe atë: nenin 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar]“.*
31. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme me të cilën do të pezullonte përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 199/2011 të Gjykatës Themelore në Rahovec të 21 qershorit 2012.
32. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme, ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Supreme E. Rev. 225/20 të 27 korrikut 2020, për shkak të shkeljes së nenit 24 (Barazia para Ligjit) si dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe ta kthejë rastin për rishqyrtim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

36. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë. (Shih, rastin e Gjykatës KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
37. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

38. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 225/20 të 27 korrikut 2020; i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, të cilat janë të qasshme bazuar në ligj, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
39. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit të kontestuar dhe aplikimit të gabuar të LPK-së dhe LMD-së ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21, 22, 23, 24, 27, 28, 31, 46, 49, 53, 54, 55 dhe 119 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, sepse (i) nuk janë aprovuar ekspertët, të cilët ai i kërkoi, (ii) nuk është llogaritur si duhet shuma e kontestit dhe në fund (iii) gjykata nuk është dashur ta aprovojë përmbarimin.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së

41. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka përmendur shprehimisht shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, duke i lidhur shkeljet e pretenduara me vërtetimin e fakteve, përkatësisht mosmarrjen parasysh të marrëveshjes së qirasë dhe zbatimin e gabuar të ligjit, pa shtjelluar më tej në baza kushtetuese, si edhe pse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve konkrete të Kushtetutës.
42. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij në baza të ligjshmërisë, përkatësisht në vërtetimin e fakteve. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
43. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
44. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
45. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
46. Në rrethanat e rastit konkret në mënyrë që edhe më konkretisht të elaborohen parimet e përgjithshme të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit si “*të palejuar*” - në aspekt procedural dhe pa shqyrtuar meritat e kërkesës. Gjykata Supreme, duke

interpretuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore ashtu siç ka vlerësuar se është mënyra më e drejtë për interpretimin e tyre, kishte theksuar se kërkesa për revizion duhet të shpallet e palejueshme meqë vlera e kontestit është nën 3,000 €. Pra, Gjykata Supreme, në baza procedurale të pranueshmërisë e ka refuzuar kërkesën e parashtresit.

47. Më saktësisht, Gjykata Supreme në aktvendimin e saj deklaroi si në vijim: *“Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin brenda kuptimit të nenit 33 të LPK-së, i cili parasheh: „Kur kontesti ka të bëjë me ekzistimin e raportit të mëditjes apo të qirasë, ose me raportin e shfrytëzimit të banesës apo të lokaleve të punës, vlera e kontestit llogaritet sipas shumës njëvjeçare të mëditjes, respektivisht të qirasë, përveç në qoftë se është fjala për raportin e mëditjes apo të qirasë që vlen për kohë më të shkurtër të kontraktuar”. Në rastin konkret, shuma e kontestit ka të bëjë me vlerën e qirasë të llogaritur për një periudhë një vjeçare, në shumën mujore prej 250,00 euro (dyqind e pesëdhjetë euro), ose 3,000.00 euro (tre mijë euro) si shumë vjetore, është e qartë se nuk është përmbushur kushti nga neni 211.2 i LPK-së i cili përcakton që revizioni lejohet vetëm nëse vlera e objektit të kontestit tejkalon shumën prej 3,000 euro (tre mijë euro), prandaj duhet të jetë më e lartë se 3,000.00 euro”*.
48. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron që parashtresi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rasti KI63/16, parashtres i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtres të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
49. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një Aktvendim i Gjykatës Supreme – sikurse ky i tanishmi - përmes së cilit ishin refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 €. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, është fokusuar vetëm në atë se a kanë përfituar parashtresit nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material duke qenë se prerogativa të tilla janë kompetencë e gjykatave të rregullta. Andaj, Gjykata rastet e tilla i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara (shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI66/18 *parashtres Sahit Muçolli*, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018, KI110/16 *parashtres Nebojša Đokić*, Aktvendim i 24 marsit 2017, KI24/16 *parashtres Avdi Haziri*, Aktvendim i 4 nëntorit 2016, KI112/14 *parashtres Srboljub Krstić*, Aktvendim i 19 janarit 2015, KI84/13 *parashtres Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj*, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).
50. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtresit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht me vendimet e Gjykatës Supreme, të Apelit

dhe atë Themelore, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rasti *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

51. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
52. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të garantuara me nenet 21, 22, 23, 24, 27, 28, 46, 49, 53, 54, 55 dhe 119 të Kushtetutës dhe me nenin 10 të DUDNJ-së

53. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenet 21, 22, 23, 24, 27, 28, 46, 49, 53, 54, 55 dhe 119 të Kushtetutës dhe me nenin 10 të DUDNJ-së. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Shkeljet e këtyre neneve parashtruesi i kërkesës në esencë i ndërlihdh me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, ndërsa këto pretendime të parashtruesit të kërkesës Gjykata tashmë i ka vlerësuar si qartazi të pabazuara (shih rastin e Gjykatës KI135/20, parashtrues *Hava Behxheti*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 dhjetorit 2020, paragrafi 54).
54. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi në nenet e Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, rastin e Gjykatës KI175/21, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 81; shih rastin e Gjykatës KI166/20, cituar më lart, paragrafi 51). Andaj, në lidhje me këto pretendime, Gjykata në përputhje me praktikën e saj kërkesën e parashtruesit e deklaroi qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.
55. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 21, 22, 23, 24, 27, 28, 46, 49, 53, 54, 55 dhe 119 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të DUDNJ-së, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij lidhur me shkeljet e të drejtave por thjesht ka cituar një ose më shumë dispozita të Konventës ose të

Kushtetutës, pa shpjeguar me atë rast se si janë shkelur ato. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

56. Gjkata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, përmes të cilës do të pezullohej përmbarimi i aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Rahovec C. nr. 199/2011 të 21 qershorit 2012.
57. Megjithatë, Gjykata tanimë konkludoi se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese.
58. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në përputhje me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit, pasi që kërkesa është deklaruar e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27.1 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Aneta Rama-Hajrizi